



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:109924
Datë: 30.08.2022
Numri i dokumentit: 03374825

PKR.nr.99/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Sabedin Mushica, me anëtarët e trupit gjykues Islam Thaçi dhe Sahit Borovci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Hikmete Veliu Pajaziti, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.F. nga fshati P., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës)¹, kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe mbajtje në pronësi, në kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-ës, të cilin me autorizim e mbron avokat av.Sh.. Sh... nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP.I.nr..../2022, të datës 30.05.2022, të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit Isuf Sadiku, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor e publik me datë 02.08.2022, i shpallur me datë 04.08.2022, ndërsa i përpiluar me datë 29.08.2022, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, S. F., nga babai M., nënra F., e lindur R..., i lindur me datë, në Gjilan, me vendbanim në fshatin P., Komuna e Gjilanit, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, student, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, konform nenit 364 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-ës)²:

LIROHET NGA AKUZA

I.

Sepse kinse me datën 28.03.2022, rreth orës 13:00 minuta, në fshatin Pogragjë, Komuna e Gjilanit, i akuzuari në mënyrë të kundërligjshme ka kultivuar paautorizim bimën e hashashit, shkurren e kokainës, ose bimën e kanabisit, me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr. 06/L-074, i datës 23 nëntor 2018, i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019.

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

substancave psikotrope, ashtu që, Policia DHTN në Gjilan, në zbatim të urdhëresës UGJK.nr.../2022, me rastin e kontrollimit në shtëpinë e të akuzuarit S. F., në fshatin P., Komuna e Gjilanit, kanë gjetur dhe sekuestruar edhe substancë të dyshuar narkotike fara të kanabisit me peshë prej 3.3gram; me ç'rast i akuzuari është arrestuar nga ana Policisë.

-me çka kishte për të kryer veprën penale, kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Ndërsa për pikën II dhe III.

ËSHTË FAJTOR

II.

Sepse me datën 28.03.2022, rreth orës 13:00 min, në fshatin Pogragjë, Komuna e Gjilanit, i akuzuari në mënyrë të kundërligjshme ka poseduar substancë narkotike me qëllim shitjes apo shpërndarjes, substanca narkotike, ashtu që, Policia DHTN ne Gjilan, në zbatim të urdhëresës UGJK.../2022, me rastin e kontrollimit në shtëpinë e të pandehurit S. F., në fshatin P., Komuna e Gjilanit, kanë gjetur dhe sekuestruar: 4 qese me substancë narkotike e llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme 8.6 gram; 3 qese me substancë narkotike e llojit marihuanë me peshë të përgjithshme 140 gram; substancë narkotike e llojit marihuanë me peshë prej 280.7 gram³; substancë narkotike e llojit kokainë me peshë 0.19 gram⁴; substancë narkotike fara të kanabisit me peshë prej 3.3 gram; 3 peshore (vaga) elektronike të llojeve dhe madhësive të ndryshme; një grinder (mulli); një pako rizlla, me ç'rast i akuzuari është arrestuar nga ana Policisë.

-me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substanca psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-ës.

III.

Sepse me datë 28.03.2022, rreth orës 13:00 minuta, Policia pas marrjes se Urdhërit për urdhërkontroll me numër UGJK.nr.../2022, gjejne se në mënyrë të paautorizuar e në shkelje të Ligjit të zbatueshëm për armët, i akuzuari ka mbajtur në pronësi edhe atë 29 fishek, kalibër të madh, 2 fishek, të kalibrit AK-47, dhe një këllëf i armës së shkurtër, një elektroshok, (bateri) e markës Police ngjyre e zezë, të cilat edhe i janë sekuestruar nga ana e policisë.

- me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontrollë, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-ës.

³ Sipas raportit të ekspertimit AKF/2022-1209/2022-1163 I dt.04.05.2022, pesha neto është 315.82 gr.

⁴ Sipas raportit të ekspertimit AKF/2022-1209/2022-1163 I dt.04.05.2022, përmban gjurme te amphetamine të përzier me kafeine, pasha neto 0.19 gr.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe 71 të KPRK-ës, nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-ës)⁵, të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

Për pikën e II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 500€(pesëqind)euro dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti.

Për pikën e III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 700€(shtatqindë)euro.

Në bazë të nenit 76 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.4 të KPRK-ës, të akuzuarit të lartcekur i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej 1200€(njëmijë e dyqind)euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë.

Nëse i akuzuari i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, gjykata do t'ia zëvendëson në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20€(njëzetë)euro të dënimit me gjobë.

Të akuzuarit të lartcekur, masa e paraburgimit i caktuar dhe vazhduar me aktvendimet e kësaj gjykate i ndërprehet me datë 04.08.2022, dhe koha e kaluar në paraburgim edhe atë nga data 28.03.2022 e deri më datë 04.08.2022, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Të akuzuarit i KONFISKOHEN dhe atë, lëndë narkotike siç janë specifikuar në pikën I dhe II, të këtij aktgjykimi, 3 peshore (vaga) elektronike, si dhe 29 fishek të kalibrit të madhë, 2 fishek të kalibrit AK47, një këllëf i armës së shkurtër, elektrohok (bateri) e markës "Police" me ngjyrë të zezë, 1 grinder (mulli) dhe një pako rizlla.

Pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë të akuzuarit do ti kthehen shuma e të hollave prej 1450€ dhe 30CH-franga zvicrane, Iphone 8 me ngjyrë të bardhë me numër të tel:.....-...-....., një palë gërshërë kopshti ngjyrë kuqe-zezë dhe një qantë krahu e meshkujve ngjyrë kaltër-hiri-zezë.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50€(pesëdhjet)euro si dhe shumën prej 50€(pesëdhjetë)euro, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, ndërsa për pjesën liruse shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve të kësaj gjykate.

A R S Y E T I M

⁵ Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Historiku i procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me datë 31.05.2022, ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.I.nr..../2022, kundër të akuzuarit S. F. nga fshati P., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-ës, kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe mbajtje në pronësi, në kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë pas leximit të aktakuzës lëndore nga prokurori i shtetit, i akuzuari S. F. ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktin akuzues dhe veprat penale për të cilat akuzohet dhe se ka pranuar fajësinë për veprat penale edhe atë: blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe mbajtje në pronësi, në kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-ës, ndërsa nuk e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 të KPRK-ës, ashtu që gjykata ka nxjerrë aktvendim procedural me të cilën ka bërë pranimin e fajësisë për pikën I dhe III të aktit akuzues, ndërsa sa i përket veprës penale të përshkruar si në pikën II të aktit akuzues është vazhduar me statet e tjera të procedurës.

Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimeve gjyqësore ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës dhe parashtresë së datës 29.07.2022, duke deklaruar se nga provat e adminstruara është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprë penale si në pikën II, të aktakuzës, andaj gjykatës i ka propozuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. F., avokat Sh. Sh., gjatë shqyrtimeve gjyqësore edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se për veprat penale, për të cilat i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë i ka propozuar gjykatës që ti merrë paraysh me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pranimin e fajësië, pendimin e tij të thellë, ndërsa për veprën penale për të cilën nuk e ka pranuar fajësinë i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta lirojë nga akuza.

I akuzuari S. F., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi deklarinimin e mbrojtësit të tij.

Konstatimet e Gjykatës

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik dhe dëgjimit të dëshmitarit dhe procedimit të provave formale e materiale, dëgjimit të akuzuarit, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se nuk është provuar se i akuzuari S. F. e ka kryer veprën penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi (në aktakuzë ka qenë dispozitivi i II), ndërsa për veprat penale si në pikën II dhe III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprat penale për të cilat akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar

në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

Provat e administruara – personale dhe materiale

Meqenëse i akuzuari nuk e kishite pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova:

- Leximi i urdhëresës UGJK.nr.../2022,
- Leximi i njoftimit mbi bastisjen dhe kontrollimin e shtëpisë,
- Leximi i raportit fillestar i incidentit,
- Leximi i raportit të shpejtë,
- Leximi i testit fushor,
- Leximi i raporteve të oficerëve,
- Leximi i formës së prones,
- Leximi i vërtetimit mbi konfiskimin,
- Leximi i procesverbalit për sekuestrim të përkohshëm,
- Leximi i vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve,
- Leximi i raportit të shiqimit të vendit të ngjarjes,
- Leximi dhe shiqimi i fotove dhe albumi,
- Leximi i raportit të ekspertimit nga AKF-ë,e dates 11.05.2022,
- Deklarata e dëshmitarit S.B. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 02.08.2022.

Përmbledhje e deklaratës së dëshmitarit

Dëshmitari S. B., në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.08.2022, në mes tjerash ka deklaruar në se ka marrur një informate të bazuar se i akuzuari është duke u marr me kultivim, mbajtje dhe posedim si dhe shpërndarje të substancave narkotike ashtu që kanë marrur një urdhëres kontrolli nga ana e gjykates dhe kanë filluar zbatimin e saj edhe atë në shtëpinë e të akuzuarit në fshatin Pogragjë, gjatë kontrollës në dhomën e të akuzuarit kanë gjetur mbi ormon disa fara të bimës kanabis sative, fara kan qenë të ndara e të cilat kanë mundur edhe të kultivohen dhe të njejtat kanë qenë të mbështjellura me foli-letër vizëlluese, me qëllim që ti mbaj të freskëta dhe të njejtat kanë qenë të terura, ku i njejtja e ka pranuar se farat i kanë mbetur gjatë kohës kur e ka konsumuar llojin e mariuhanës, këto fara janë si të bimëve të zakonshëm të cilat nëse don i mbjell në vitin tjetër duhet me i tha –terur, kurse përfitohet prej mariuhanës të cilën e konsumojnë. Më tutje ka deklaruar se nuk mjafton vetëm gjetja e farave për ta vërtetuar veprën penale kultivimi i bimëve narkotike dhe nuk mund të dëshmoj se farat e gjetura a i ka pasur për kultivim apo shfrytëzim, ashtu që tek i akuzuari nuk kanë gjetur fidanë të kanabisit, këto bimë zhvillohen për përdorim në laboratorë në tri deri në gjashtë javë, ndërsa jashtë kultivimi i kësaj bime zgjatë më tepër, për kultivimin e kësaj bime narkotike në ambient të brendshëm duhet të jetë objekti i mbyllur, i nxehtë, i ndriçuar me drita që e kryejnë rolin e diellit, ndërsa në ambient të jashtëm vetëm duhet me ujit tjetër gjë nuk duhet për kultivim.

Përmbledhje e provave materiale

Nga urdhëresa e kësaj gjykate me numër UGJK.nr.../2022, të datës: 28.03.2022, gjykata ka konstatuar faktin e një bastisje të shtëpia e S. F., për shkak të dyshimit të arsyeshëm për veprën penale kultivimi i bimës së hashashit, shkures së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 të KPRK-ës.

Nga njoftimit mbi bastisjen dhe kontrollimin e shtëpisë, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se është bërë njoftimi për të drejtat dhe njoftimi për të gjitha kontrollet.

Nga raporti fillestar i incidentit, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se me datë 28.03.2022 ,koha 13:00, lokacioni fshati Pogragjë, veprat për të cilat dyshohet vepra blerja, posedimi,shpërndarja dhe shitja e narkotikëve, substanca psikotrope dhe analoge nga neni 267, kultivimi i bimës së hashashit, shkures së kokainës ose bimëve te kanabisit nga neni 272, mbajtja në pronësi kontroll ose posedim pa autorizuar të armëve nga neni 366.,

Nga raporti i shpejtë, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se me datë 28.03.2022 rreth orës 13:00, është realizuar bastisja sipas urdhëresës UGJK.nr. ../2022, në shtëpin e të dyshuarit dhe objekteve përcjellëse në cilësi të provave materiale janë sekuestruar, 280.7gr marihuanë, 140gr marihuanë, 8.6gr marihuanë, 3.3 fara për kultivim, 0.6gr kokainë, para të gatëshme në vlerë prej 1450€, para të gatëshme në vlerë 30 Franga, një elektroshok, 3 peshore elektrike, 27 municion (fishekë) të kalibrit të rëndë, 2 copa (fishekë) të kalibrit A/47, sasië e kofiskuar e narkotikëve në total prej431gr.

Nga testit fushor, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se lëndët narkotike kanë rezultuar të llojit Marihuanë dhe Kokainë, edhe atë me peshë 429.3 gram dhe 0.6gram.

Nga forma pronës, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se është paraqitur skica e planit të dyshemesë, dhomave, si dhe katet e objektit të kontrolluar (kati përdhësë/kati/1/2/3), me rastin e urdhër kontrollit.

Nga vërtetimi mbi konfiskimin, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se në procesverbalin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve në pjesën e katër të procesverbalit janë konstatuar sendet të cilat janë konfiskuar.

Nga procesverbalit për sekuestrim të përkohshëm, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se cilat sende janë sekuestruar përkoheshisht më datë: 28.03.2022.

Nga vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 28.03.2022, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se janë sekuestruar përkohsishtë edhe atë: 4 qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshe të përgjithëshme 8.6gram, 3 qese substancë narkotike të llojit marihuanëme peshe të pergjithshme 140gram, fara të kanabisit në peshë prej 3.3 gram, substancë narkotike e llojit marihuane me peshë 280.7 gram, substancë narkotike e llojit kokainë me peshë 0.6 gram, 3 peshor (vaga) elektronike të markave dhe madhësive të ndryshme, 27 fishekë të kalibrit të madhë dhe 2 fishek të kalibrit për AK47+1 këllëf i armës së shkurtër, elektroshok (bateri) e markës “Police” me ngjyrë të zezë, para të gatëshme me vlër 1450€+30 franga Zvicrane 1x500 €, 3x200 €, 1x100 €, 4x50 €, 2x20€,1x10€, 1x20 CF,1x10 CF, grinder (mulli) dhe një pako rizlla, 1 palë gërrshër kopshti ngjyrë kuq-zezë, 1 qantë krahu e meshkujve ngjyrë kaltër-hiri-zezë.

Nga raporti i shiqimit të vendit të ngjarjes, gjykata mes tjerash ka konstatuar faktin se me datë 28.03.2022, rreth orës 13:20, ka marrë një thirrje nga kapiteni lidhur me një rast që kishte

ndodhur në fshatin P., në atë mënyrë që të asiston njësitë anti Drogë , të cilët kishin gjetur një sasi të dyshuar për narkotikë, ku rreth orës 13:50, kanë arritur në fshatin Pogradec në shtëpinë e M. F., dhe aty kanë takuar njësitin anti- Drogë, pasi që kanë kryer punë në atë shtëpi nga togeri është njoftuar se duhet të shkojnë edhe në shtëpinë tjetër të S. F., ku aty kanë gjetur substanca të dyshuar për narkotikë dhe disa gjëra të tjera edhe atë: 431gram sasisë të narkotikëve, 6 gram substancë të dyshuar si kokainë, 3.3gram fara për kultivim, 1450€, 30 franga, një elektroskok, peshore elektrike, 29 fishekë të kalibrit 7.62x39.

Nga foto-albumi, gjykata në mes tjerash ka konstatuar faktin se me rastin e bastisjes në shtëpinë e të akuzuarit S. F., ku është bërë fotografia e shtëpisë së të njëjti si dhe janë gjendur: lëndët narkotike, elektroskoki, para të gatëshme etj.

Nga raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, e datës 11.05.2022, gjykata në mes tjerash ka konstatuar se sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike sipas dëshmive përmbajnë kanabis marihuana që përbërn tetrahidrokanabinol (THC), pesha neto e përgjithshme 315.82+-0.000.1, sipas përbërjes kimike nga dëshmia #4 përban gjurmë (idnikacion) të amfitaminës të përzier me kafeinë, sipas përbërjes kimike dëshmia #4.1, përmban amfetaminë të përzier me kafeinë pesha neto 0.19+-0.000.1gram.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari S. F., në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.08.2022, në mes tjerash ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë sa i përket dispozitivi II të aktakuzës dhe se farat i ka marr prej mbetjeve të marihuanës të cilën e ka konsumuar, ku farat nuk konsumohen i ka ndarë duke i konsideruar si mbeturina dhe të njëjtat i ka hedhur në mbeturina, ku zakonisht marihuanën e ka konsumuar në dhomën e tij, qëllimi që i ka ruajtur farat ka qenë që ti hedhë në mbeturina që të mos gjinden nga familjarët e tij, ku farat me qëndruar në dhomë nuk kanë ndikim tek njerëzit dhe arsyeja pse i ka mbështjellur të njëjtat ka qenë që ti hudhi në bërlllog, ku këto janë bërë për një periudhë të shkurtër kohore dhe atë brenda ditës, më tutje ka deklaruar se nuk e ka ditur sigurt se ato fara mund të mbillen, ku ka patur raste që i ka ndarë farat e marihuanës dhe të njëjtat i ka hedhur në mbeturina.

Vlerësimi dhe analizimi i provave.

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata komfor nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit e si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç'rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundimin se nuk duhet ti falet besimi provave të prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit sa i përket pikës së I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nuk është konstatuar fakti se me datë 28.03.2022, rreth orës 13:00, zyrtarët policor në shtëpinë e të akuzuarit S. A., me rastin e bastisjes në mes tjerash kanë gjetur edhe substancën narkotike fara të kanabisit me peshë prej 3.3 gram.

Në këtë çështje penale kontestues ka qenë fakti se i akuzuari S. A. a e ka kultivuar-mbjellur substancën narkotike?

Trupi gjykues pas administrimit të provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të cilat prova janë vlerësuar dhe analizuar një nga një dhe të gjitha sa bashku, ashtu siç parashihet në nenin 362 paragrafi 2 të KPP-ës, ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari S. F. ta ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Në radhë të parë, me asnjërin prej provave të administruara nuk është vërtetuar nëse i akuzuari i lartcekur të ketë ndërmarrë ndonjë veprim përkatës, siç është cekur në pikën e I, të dispozitivit të këtij aktgjykim, që të njejtën sasi narkotiku ta ketë kultivuar, siç është specifikuar në aktakuzë edhe atë në dispozitivin e I të aktakuzës ku është cekur shprehimisht në rreshtin e dytë "... Se me datën 28.03.2022, rreth orës 13:00 minuta, në fshatin Pogragjë, Komuna e Gjilanit, i akuzuari në mënyrë të kundërligjshme ka kultivuar paautorizim bimën e hashashit, shkurren e kokainës, ose bimën e kanabisit, me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose substancave psikotrope,.... me rastin e kontrollimit në shtëpinë e të akuzuarit S. F., në fshatin Pogragjë, Komuna e Gjilanit, kanë gjetur dhe sekuestruar edhe substancë të dyshuar narkotike fara të kanabisit me peshë prej 3.3gram; me ç'rast i akuzuari është arrestuar nga ana Policisë"... Për Gjykatën një pretendim i tillë i Prokurorisë nuk qëndron pasi që është dashur të vërtetohet me prova konkrete se të njejtat fara a kanë qenë të kultivume, e aq më tepër të njejtat fara të akuzuarit i janë gjetur përmbi orman në shtëpinë e tij të mbështjellura me foli.

Gjykata rikujton faktin se bimët (substancat) narkotike që janë gjetur mbi orman, nuk paraqesin provë të mjaftueshme që i akuzuari e ka mbjellur atë me qëllim të kultivimit, ngase të njejtat bimë kanë qenë të mbështjellura me foli, prokuroria është dashur që këtë fakt ta provoj me prova konkrete bindëse për të bindur Gjykatën për një gjë të tillë se ajo substancë është mbjellur nga i akuzuari, pra vetëm substancat narkotike që janë gjetur në shtëpinë e të akuzuarit mbi orman nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale të kultivimi i bimës së hashashit, shkurren së kokainës kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 të KPRK-ës, ku nga administrimi i të gjitha provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarit, respektivisht hetuesi policor me rastin e bastijes nuk janë gjetur mjetet tjera që i përdorin për kultivimin e bimëve narkotike, e aq më tepër vet dëshmitari ka deklaruar se ... se nuk mjafton vetëm gjetja e farave për ta vërtetuar veprën penale kultivimi i bimëve narkotike dhe nuk mund të dëshmoj se farat e gjetura a i ka pasur për kultivim apo shfrytëzim, ashtu që tek i akuzuari nuk kanë gjetur fidanë të kanabisit, këto bimë zhvillohen për përdorim në laboratorë në tri deri në gjashtë javë, ndërsa jashtë kultivimi i kësaj bime zgjatë më tepër, për kultivimin e kësaj bime narkotike në ambient të brendshëm duhet të jetë objekti i mbyllur, i nxehtë, i ndriçuar me drita që e kryejnë rolin e diellit, ndërsa në ambient të jashtëm vetëm duhet me ujit tjetër gjë nuk duhet për kultivim. Sipas vlerësimit të Gjykatës pretendimi i Prokurorisë që i akuzuari ka kultivuar paautorizim bimën e hashashit... "një pretendim i tillë në raport me veprimet e tilla të të akuzuarit të pretenduar nga ana e Prokurorisë më tepër ngjajnë me një supozim sepse me asnjë provë të vetme të paraqitur nga Prokuroria nuk mund të vërtetohet ky fakt se i akuzuari është kujdesur që këto substanca narkotike që nga mbjellja, rritja e deri tek vjelja e bimëve narkotike edhe pse të njejtat nuk kanë qenë fare të mbjellura.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarve dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Rrethanat mbi bazën e të cilave është shqiptuar dënimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata për të akuzuarin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese në raport me veprën penale si në pikën e I dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, mori pranimin e fajësisë, pendimin, premtimin se nuk do të kryejë vepra tjera penale, moshën e tij të re. Si rrethanë rënduese gjykata mori shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat nën të cilat janë kryer veprat penale, duke patur parasysh se veprimet e ndërmarra nga i akuzuari janë veprime të një përgjegjësie penale me të lartë e në veçanti rrethanat nën të cilat i akuzuari i ka kryer veprat penale, duke e marrë parasysh se ky llojë i veprave penale, është në rritje e sipër.

Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Andaj gjykata duke u nisur nga të gjitha këto i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim efektiv.

Vendimi lidhur me konfiskimin

Konfrom nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-ës dhe nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-ës, të akuzuarit S. F. i KONFISKOHEN dhe atë, lëndët narkotike siç janë cekur në pikën I dhe II të aktgjykimit, 3 peshore (vaga) elektronike, si dhe 29 fishek të kalibrit të madhë, 2 fishek të kalibrit AK47, një këllëf i armës së shkurtër, elektroshok (bateri) e markës "Police" me ngjyrë të zezë, 1 grinder (mulli) dhe një pako rizlla.

Vendimi lidhur me kthimin e sendeve

Gjykata komfor nenit 116 të KPP-ës, të akuzuarit S. F., ka vendosur që pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, të njejtit t'ia kthehen edhe atë shumën e të hollave prej 1450€ dhe 30 CH-franga zvicrane, Iphone 8 me ngjyrë të bardhë me numër të tel:-.....-....., një palë gërshërë kopshti ngjyrë kuqe-zezë dhe një qantë krahu e meshkujve ngjyrë kaltër-hiri-zezë, me arsyetimin se për të gjitha këto sende nuk është vërtetuar se kanë ardhurë si rezultat i veprave penale të lartcekura.

Vendimi për ndërprejen e paraburgimit

Duke u bazuar në nenin 367 paragarfi 1 të KPP-ës, gjykata të akuzuarit të lartcekur i'a ka ndërprerë masën e paraburgimit me datë 04.08.2022 dhe në kuptim të nenit 79 të KPRK-ës,

kohën e kaluar në paraburgim edhe atë prej datë 28.03.2022 e deri më 04.08.2022, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh faktin se i akuzuari, për pikën e I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi i njejtë është liruar sa i përket shpenzimeve të procedurës, bien na barrë të mjeteve të kësaj gjykate edhe atë duke u bazuar në nenin 454 të KPP-ës, ndërsa duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50€, si dhe shumë prej 50€, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
PKR.nr.99/2022
Me datë: 29.08.2022

Kryetari i trupit gjykues,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.